



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 031-18626 me 25.07.2016

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31/15 qershor 2008), të nenit 53 të Statusit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me datën 25.07.2016 merr këtë

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE
PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE TË KOMUNALE "STACIONI I AUTOBUSËVE
PRISHTINË".**

I

Dardan Sejdiu, CAKTOHET anëtarë në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike të Komunës së Prishtinës; "Stacioni i Autobusëve Prishtinë".

II

Anëtari i cekur në pikën I të këtij Vendimi së bashku me dy anëtarë të cilët i emëron Kuvendi i Komunës e përbëjn komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen komunale "Stacioni i Autobusëve Prishtinë".

III

Anëtari i komisionit komunal të aksionareve, i caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Komunës

IV

Veprimet e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.

V

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

IU DORËZOHET:

- Anëtarit;
- Administratës së Ndërmarrjes "Stacioni i Autobusëve Prishtinë";
- Qendrës për shërbimeve me qytetar.
- Në Dosje

KRYETARI I KOMUNES
Shpend Ahmeti

